

**RELACION**  
**PËR**  
**PROJEKTLIGJIN**

**“PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10465, DATË  
29.09.2011 “PËR SHËRBIMIN VETERINAR NË REPUBLIKËN E  
SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË  
SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi i këtij projektligji është që nëpërmjet ndryshimeve në ligjin nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar të bëhet e mundur zbatimi i reformës së shërbimit veterinar dhe plotësimi i kuadrit ligjor për unifikimin e tij duke mundësuar kalimin e kompetencave dhe funksioneve të shërbimit veterinar të pushtetit lokal në strukturën e shërbimit veterinar në MBZHR pasi me miratimin e ligjit nr. 139/2015 ”Për vetëqeverisjen vendore”, njësitë e qeverisjes vendore nuk i kanë më këto struktura.

Gjithashtu gjatë zbatimit të detyrave të përdishme, shërbimi veterinar ka hasur vakume ligjore të ndryshme të pa pasqyruara në ligjin nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nëpërmjet këtyre ndryshimeve synohet të përmirësohet kuadri ligjor për të mbështetur punën e shërbimit veterinar në ngritjen e standardeve me lidhje me shëndetin e kafshëve dhe regjistrimin e Produkteve Mjekësore Veterinare.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN  
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN  
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA  
POLITIKE**

Ky projektakt del si nevojë në plotësimin e kuadrit ligjor në lidhje me kalimin e kompetencave dhe funksioneve të shërbimit veterinar të pushtetit lokal në strukturën e shërbimit veterinar në MBZHR dhe vakume ligjore të ndryshme duke synuar përmirësime në kuadrin ligjor në mbështetje të punës së shërbimit veterinar në arritjen e objektivave dhe standardeve të BE-së të përcaktuara në politikat dhe strategjitë e Qeverisë në tërësi dhe MBZHR në veçanti.

Ky projektligj është parashikuar në Programin Analitik të Akteve që do të paraqiten për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Ministrave në vitin 2018.

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Nëpërmjet ndryshimeve që sjell ky projektligj do të mundësohet që:

- Të unifikohet shërbimi veterinar aktualisht i fragmentuar në atë të shërbimit veterinar në strukturat e MBZHR dhe atë në njësitë e qeverisjes vendore.
- Fusha e veprimtarisë së veterinerit zyrtar do të përfshijë edhe kontrollin shëndetësor të kafshës para dhe pas therjes, tregjet e kafshëve të gjalla, kullota dhe njësitë e shitjes së kafshëve të shoqërimit dhe zbukurimit.
- Të përmirësohet procedura e regjistrimit të Produkteve Mjekësore Veterinare dhe lejimit të hyrjes dhe tregëtimit të tyre vetëm pasi ai tregëtohet në të paktën në një nga vendet e BE-së.
- Në ferma të zbatohen masat për biosigurinë me qëllim reduktimin e rrezikut të hyrjes, zhvillimit ose përhapjes të sëmundjeve tek kafshët në fermë dhe/ose objekt, zonat ose çdo ambienti tjetër dhe mjetet e transportit”.

### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Ky projektligj është hartuar në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, të Kushtetutës.

### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Ky projektligj nuk ka përafrim me legjislacionin e BE-së.

### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Në këtë projektligj ka 34 nene të cilat kanë përmbajtje si më poshtë:

- Në nenin 1 përcaktohen rregullat për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve në lidhje me klasifikimin e tyre, vendosjen e masave urgjente që duhen marrë në rast të shpërthimit, miratimin dhe regjistrimin e objekteve dhe mjeteve transportuese, garantimin e lëvizjes dhe gjurmueshmërisë për hyrje daljen e kafshëve, produkteve embrionale dhe produkteve me origjinë shtazore, jo për konsum human në Shqipëri.

- Në nenin 2 shtohet objekti i ligjit për kafshët, produktet embrionale, produktet me origjinë shtazore jo për konsum human, subjektet, mjetet e transportit, pajisjet si dhe, si dhe çdo material i cili ndikon ose është i prirur të ndikojë në përhapjen e sëmundjeve të transmetueshme të kafshëve.
- Në nenin 3 plotësohen përkufizimet edhe për termat Biosiguri, Hetim epidemiologjik, Sistemi i informacionit të epidemiologjisë veterinarë, Stabiliment dhe Survejancë.
- Në nenin 4 përcaktohen llojet e kafshëve të prodhimit që do të identifikohen, është shtuar njëhundurakët, dhe rastet kur ministri urdhëron identifikimin e llojeve të tjera të kafshëve.
- Në nenin 5 ndryshimi nga identifikimi i qenve në kafshët e shoqërimit.
- Në nenin 6 përcaktohet që shërbimi veterinar të kryejë monitorimin e sëmundjeve të listuara dhe plotësimi i kësaj liste me sëmundje e reja që shfaqen.
- Në nenin 7 përcaktohen masat e përgjithshme profilaktike dhe masat shtesë të kontrollit të sëmundjeve.
- Në nenin 8 përcaktohet që autoriteti kompetent përgatit programet vjetore të profilaksisë veterinarë shtetërore, kontrollit, monitorimit dhe mbikëqyrjes së sëmundjeve me pasoja për shëndetin e kafshëve dhe shëndetin publik veterinar, mbështetur në situatën epidemiologjike në vend.
- Në nenin 9 plotësohen veprimet e veterinerit zyrtar në rastin e dyshimit të një sëmundjeje infektive.
- Në nenin 10 përcaktohen masat paraprake profilaktike në rastin e dyshimit të një sëmundjeje infektive.
- Në nenin 11 përcakton që ministri miraton rregulloret përkatëse për masat që duhet të zbatohen për kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve në fermën e vendosur nën mbikëqyrje zyrtare.
- Në nenin 12 përcaktohet që autoriteti kompetent mbikëqyr kryerjen e kontrolleve zyrtare veterinarë periodike.
- Në nenin 13 bëhen ndryshimet për masat që merr autoriteti kompetent për kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve, në të cilat përfshihen eliminimi i kafshëve të sëmura, të dyshuara të sëmura, ose të ekspozuara kundrejt infeksionit, asgjësimin e kadavrave, produkteve të kafshëve, produkteve embrionale, të lëndëve të papërpunuara dhe të pajisjeve e mjeteve në një vatër të sëmundjes, që paraqet rrezik për shëndetin e kafshëve.
- Në nenin 14 shtohen detyrat për pronarët ose kujdestarët e kafshëve të

prodhimit lidhur me masat e boisigurisë në fermë, sipas llojeve dhe kategorive të kafshëve, llojit të mbarështimit si dhe parashikohet miratimi i rregullores nga ministri për masat e biosigurisë në fermë.

- Në nenin 15 përcaktohet bashkëpunimi i njësive të qeverisjes vendore dhe shërbimit veterinar. Lidhur me zbatimin e masave profilaktike, kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive në kafshë, kontrollin e qenve dhe maceve të rrugës, përcaktimin e vendgroposjes dhe eliminimin e kadavrave të kafshëve, rrethimin dhe ruajtjen e pikave të grumbullimit të mbetjeve.
- Në nenin 16 përcaktohet që autoriteti kompetent mbikqyr dokumentat mjekësore veterinarë për përputhjen e tyre me kërkesat e përcaktuara për procedurën e lëshimit të tyre.
- Në nenin 17 përcaktohet detyrimi i subjekteve organizatore të ekspozitave dhe panaiereve, kur këto organizime bëhen jashtë mjediseve të stallave dhe stabilimenteve, të njoftojnë paraprakisht me shkrim shërbimin veterinar rajonal për vendin, datën dhe orën e zhvillimit të aktivitetit si dhe miratimi nga ministri të kushteve dhe kriterëve për organizimin e tyre.
- Në nenin 18 përcaktohet detyrimi i Veterinerit zyrtar të urdhërojë eliminimin e detyrueshëm në vend për kafshët me dëmtime të rënda.
- Në nenin 19 përcaktohen rregullat për lëvizjen e kafshëve të egra tokësore kur lëvizin nga një vendbanim në Shqipëri në një vendbanim tjetër në Shqipëri, ose në një shtet tjetër. Gjithashtu në këtë nen përcaktohet që kafshët e egra gjatë lëvizjes të shoqërohen me një çertifikatë shëndetësore ose dokumente të tjera veterinarë të përcaktuara nga Autoriteti kompetent, dhe ku çertifikimi i shëndetit të kafshëve është i nevojshëm për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e shëndetit të kafshëve për lëvizjet e parashikuara. Përcaktim tjetër në këtë nen është dhe miratimi me urdhër të ministrit të Rregullave të hollësishme për lëvizjen e kafshëve të egra.
- Në nenin 20 përcaktohen afatet për miratimin nga Komisioni Shtetëror i PMV-ve, afat i cili nga 210 ditë që është përcaktuar është parashikuar të jetë 100 ditë, kjo me qëllimin që të përshpejtohen procedurat në ndihmë të subjekteve që kërkojnë të regjistrojnë dhe tregtojnë PMV.
- Në nenin 21 në kuadër të farmako-vigjilencës përcaktohen kriteret në përdorimin e PMV-ve në kafshë për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve, bazuar në karakteristikat, profilin, përhapjen e sëmundjes, disponueshmërinë dhe efikasitetin e PMV-ve dhe rreziqet e pasojat

ekonomike nga sëmundjet. Gjithashtu në këtë nen përcaktohet se rregullat për përdorimin e këtyre PMV-ve miratohen me urdhër të ministrit.

- Në nenin 22 përcaktohet e drejta e ministrit të miratojë rregulloren për funksionimin e Klinikave dhe Spitaleve veterinarë.
- Në nenin 23 riformulohet kryerja e veprimtarive veterinarë nga klinika veterinarë me anë të një kontrate me shërbimin veterinar rajonal, të lidhur në bazë të legjislacionit në fuqi si dhe e drejta e shërbimit veterinar rajonal për zgjidhjen e njëanshme të kontratës para përfundimit të afatit të përcaktuar në të, penaltetet e dëmshpërblimi në rastin kur klinika nuk përmbush kushtet e kontratës Në nenin 24 përcakton shfuqizimin e nenit 117 për arsye se përcaktimet në këtë nen janë parashikuar në ndryshimet e nenit 116 .
- Në nenin 25 përcaktohet varësia e laboratorëve veterinarë shtetërorë nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) në një rrjet, konkretisht të pesë laboratorëve rajonal të shëndetit të kafshëve që aktualisht janë nën varësinë e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.
- Në nenin 26 përcaktohen masat e laboratorëve në lidhje me biosigurinë dhe të izolimit biologjik me qëllim ndalimin e përhapjes së agjentëve patogjene.
- Në nenin 27 përcaktohet përbërja e shërbimit veterinar rajonal nga veterinerët zyrtarë në strukturat përkatëse si dhe shfuqizohet pika për strukturat veterinarë në njësitë e qeverisjes vendore dhe veprimtaritë që mbulojnë ato.
- Në nenin 28 përcaktohet bashkëpunimi dhe marrëveshjet me Policinë e Shtetit me qëllim ndihmën për shërbimin veterinar në zbatim të këtij ligji.
- Në nenin 29 përcaktohet plotësimi i fushës së veprimtarisë së veterinerit zyrtar, duke shtuar edhe funksionet që kanë strukturat veterinarë të qeverisjes vendore, si dhe përcaktohet miratimi nga ministri i formateve të listave të kontrollit.
- Në nenin 30 përcaktohen funksionet e veterinerit zyrtar për kontrollet në thertore, tregjet e kafshëve të gjalla dhe kullota, njësitë e shitjes së kafshëve të shoqërimit dhe mbledhjen, grumbullimin dhe groposjen e kadavrave të kafshëve.
- Në nenin 31 përcaktohet që mjeku veterinar i autorizuar mund të ushtrojë funksionet e veterinerit zyrtar pas pajisjes së tij me autorizim nga autoriteti kompetent.
- Në nenin 32 përcaktohet masat për kundërvajtjet administrative, kur veprohet në kundërshtim në lidhje me masat e përgjithshme profilaktike dhe prodhimin e PMV-ve në vend, kundravajtje të cilat nuk janë të

përcaktuara më parë në nenin që shtohet.

- Në nenin 33 përcaktohet që Autoriteti kompetent për licencimin, anulimin ose shfuqizimin e licencës për do të zbatojë ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për veprimtaritë të cilat i përkasin kategorive e nënkategorive respektive të fushës II të shtojcës të këtij ligji.
- Në nenin 35 përcaktohet hyrja në fuqi e ligjit.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si ministria përgjegjëse për shërbimin veterinar, ka përgatitur këtë projektligj.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Miratimi i ndryshimeve ligjore të sipërpërmëndura nuk ka kosto financiare shtesë.

**MINISTRI**

**NIKO PELESHI**